

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	25.01.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/5811/731/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan Eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Korretishtë- Novobërdë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan, me nr. prot. 18/5811/731/DMMU, të datës: 08.10.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan, për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Korretishtë-Novobërdë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

#### V E N D I M

#### Leje Mjedisore

Kompanisë K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan, për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Korretishtë- Novobërdë.

#### A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan, për veprimtarinë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, në ngastrën kadastrale nr. P- 72403034-01721-0, zona kadastrale Korretishtë- Novobërdë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar;
- Raporti i rezultateve për monitorimin e cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;

Faqe 2 nga 3





- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës të njoftoj MMPH;
- Sistemi i ujitjes të jetë funksional;
- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku behet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- Të i përmbaheni kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrotje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5811/ZSP/29/19 datë: 25.01.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:


1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU  
  
 Sekretar i Përgjithshëm



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu*

DATË/A:	25.01.2019
REFERENC-Ë:	18/5811/731/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse për lëshuarjen e Lejes Mjedisore 

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania K.P.N.P "Pro Eng" Sh.p.k. Gjilan, me nr. prot. 18/5811/731/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Korretishtë- Novobërdë, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1